

## **Komentet e Kryetarit të Prezencës, Ambasadorëve të BE dhe SHBA pas takimit me Kryetarin e PS**

*5 Tetor 2011*

**Ambasadori Wollfarth:** Të tre ne, Ambasadorët Arvizu, Sequi dhe unë, u takuam me kreun e Partisë Socialiste për të diskutuar rreth situatës politike aktuale. Ai na kishte kërkuar të takoheshim së bashku dhe kështu patëm një takim shumë të frytshëm në lidhje me procesin që po zhvillohet këtë vjeshtë. Ky proces duhet të ecë përpara. Janë bërë propozime të rëndësishme dhe z. Edi Rama na dha informacion shtesë rreth këtyre propozimeve. Bëhet fjalë për një listë të hapur, e cila nis me mënyrën se si duhet të funksionojë Kuvendi, me atë se si mund të jetë Kodi Zgjedhor në të ardhmen, si edhe pika të tjera. Ne mendojmë që është e rëndësishme që lista është e hapur dhe shërben si propozim për dialog me shumicën qeverisëse. Duhet shqyrtuar me seriozitet të plotë nga të gjitha palët e interesuara dhe, në qoftë se trajtohet brenda një kornize kohore të arsyeshme, do të bëjë të mundur që të shohim disa rezultate përpara ose gjatë pranverës së ardhshme. Ne jemi këtu për të ofruar mbështetje, për t'i vënë në lëvizje palët, për t'i ndihmuar ato që të ecin përpara. OSBE-ja është veçanërisht e gatshme për të mbështetur çdo lëvizje kur bëhet fjalë për të gjetur pikat e përbashkëta dhe për të identifikuar rrugën për të ecur përpara, sidomos kur bëhet fjalë për integrimin evropian.

**Ambasadori Sequi:** Jam plotësisht dakord me deklaratën e Ambasadorit Wollfarth. Do të shtoj vetëm diçka: Gur gur bëhet mur.

**Ambasadori Arvizu:** E mbështes plotësisht atë që thanë dy kolegët e mi. Shtetet e Bashkuara e mbështesin me gjithë zemër rrugën e integritit të Shqipërisë dhe ne po përpiqemi të heqim pengesat drejt realizimit të këtij qëllimi.